

VENDIM
Nr. 859, datë 21.10.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Titulli i lidhjes nr. I/3, që përmendet në pikën 4, të vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë dhe në Shkollën e Magjistraturës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama